



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:117937
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05505905

AC.nr.7542/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Liridon Maloku dhe Bujar Muzaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëseve B. M., H. M., K. M., I. M. dhe Z.M. të gjithë nga fshati N., Komuna e P., përfaqësuar nga Z.M., me adrese rr. xxxx P, kundër të paditurit M. K., nga Prishtina, (trashëgimtar i A. K.), përfaqësuar nga av. A. M., nga Prishtina, Rrxxxxx lidhur me çështjen juridike lirim i vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, ushtruar nga paditësi i pestë, njëherit edhe i autorizuar për të paditurit tjerë, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4134/20 të datës 29.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **26.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e paditësve B. M., H. M., K.M., I. M.dhe Z. M. të gjithë nga fshati N./Komuna e P., ushtruar nga paditësi Z. M., njëherit i autorizuar edhe për paditësit e tjerë, ashtu që: **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.4134/20, i datës 29.09.2023, dhe çështja i kthehet në **ri vendosje**, gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar C.nr.4134/20, i datës 29.09.2023 , ka vendosur si në vijim:

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësve paditëseve B. M.H. M., K. M., I. M. dhe Z.M. të gjithë nga fshati N.n, Komuna e P., e parashtruar me datë 21.08.2021, kundër të paditurit M. K., nga P., lidhur me çështjen juridike lirim i palujtshmërisë.

- II. DETYROHEN paditësit qe në mënyrë solidare, në emër të shpenzimeve procedurale te paditurit ti kompensojnë shumën prej 4,664.40€, në afat prej 15 ditkësh nga dita a plotfuqishmërisë se këtij Aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor ankesë kanë ushtruar paditësit, përmes paditësit të pestë Z. M., njëherit i autorizuar edhe për paditësit tjerë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që gjykata e shkallës së dytë ta miratoj ankesën e parashtruesit dhe ta prish aktvendimin e ankimuar dhe çështjen ta kthej në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e paditësve, brenda afatit ligjor është ushtruar nga i padituri M. K., përmes të autorizuarit të tij, avokat A. M. nga P., me të cilën i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, me propozim për gjykatën e shkallës së dytë që ankesa e paditësve të refuzohet dhe aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 208 dhe 209, pika d) të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e paditësve B. M., H.M., K.M., I. M. dhe Z. M., të gjithë nga fshati N./Komuna e P., ushtruar nga paditësi Z. M., njëherit i autorizuar edhe për paditësit e tjerë, rezulton e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me datën 21.08.2003, pranë ish Gjykatës Komunale në Prishtinë, kanë ushtruar padi kundër të paditurit A. K. nga P. (i ndjerë), tani me trashëgimtarin e tij ligjor këtu të paditurin M.K. nga P., për shkak të pasurimit të pa bazë.

Gjykata e shkallës së parë, pas kthimit të lëndës në rigjykim për disa herë me radhë ka caktuar seancën gjyqësore me datën 14.09.2023, ku si palë ndërgjyqëse njëherit edhe përfaqësues për paditësit tjerë, me ftesë ka ftuar paditësin e pestë Z. M. nga fshati N./Komuna e P., si dhe palën e paditur M. K. përmes të autorizuarit të tij, avokat A. M., ashtu që, në seancën përgatitore të datës 14.09.2023, meqë, ka konstatuar se nga paditësit nuk prezanton askush pas deklarimit të palës së paditur, mbi bazën e nenit 409.1 të LPK-së, ka nxjerr aktvendimin e ankimuar me të cilin padinë e paditësve kundër të paditurit e ka konsideruar të tërhequr, ndërsa për shpenzimet e procedurës pas specifikimit të tyre nga pala e paditur ka vendosur që paditësit solidarisht t'ia paguajnë palës së paditur shpenzimet e procedurës.

Lidhur me arsyet e dhëna për mënyrën e vendosjes, në aktvendimin e ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për datën 14.09.2023, gjykata ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk ka prezantuar askush për paditësit, edhe pse në shkresat e lëndës ka prova se për të njëjtit është ftuar në mënyrë të rregullt paditësi Z. M., i cili njëherit përfaqëson edhe paditësit tjerë, fakti ky që u vërtetua nga fletë kthesa për dorëzim personal të ftesës, nga e cila shihet se ftesën për seancë e ka pranuar me datë 05.07.2023, mungesën nuk e ka arsyetuar, e as nuk ka kërkuar shtyrje të seancës.

Në mënyrë të rregullt është ftuar edhe i padituri, deri në atë faze të procedurës A.K., e në të cilën seancë prezantoi djali i tij M. K., si dhe av. A. M., përfaqësuesi i tij i autorizuar, i cili i e njoftoi gjykatën se i padituri A. K. ka vdekur, duke theksuar se M. K. është shpallur trashëgimtari i vetëm i të ndjerit A.K. dhe i ka propozuar gjykatës që i njëjti të lejohet si pale e paditur në këtë çështje juridike, qka edhe gjykata në seance lejoi që si pale e paditur në këtë çështje juridike nga tani e tutje të jete M. K., trashëgimtar i të ndjerit A. K..

Përfaqësuesi i të paditurit i propozoi gjykatës që të konsideroj të tërhequr padinë e paditësve, pasi që për këtë janë krijuar kushtet ligjore.

I njëjti me parashtrësë të veçanet (datë 5.09.2023) kërkoi shpenzimet e procedurës, duke i specifikat të njëjtat për 15 seanca të mbajtura, për secilën nga to 405.60€, (për datat 08.06.2014, 29.09.2014, 17.10.2014, 31.10.2014, 24.11.2014, 03.02.2014, 12.03.2015, 24.04.2015, 13.05.2015, 30.06.2015, 31.07.2015, 21.09.2015, 04.11.2015, 07.12.2015, 14.09.2023) si dhe për përpilimin e ankesës se datës 12.02.2016, kundër Aktgjykimit C.nr.2461/2009 shumen prej 614.00€.

Në bazë të nenit 409.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashihet se “në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit”.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, lidhur me të njëjtat bazuar edhe në dispozitat ligjore të LPK-se, nenit 452.1 vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke i njohur të paditurit shpenzimet e procedurës dhe atë për seancën e datës 29.09.2014, 17.10.2014, 31.10.2014, 24.11.2014, 03.02.2014, 24.04.2015, 30.06.2015, 31.07.2015, 04.11.2015, 07.12.2015, 14.09.2023 të cilat janë mbajtur, një seance e shtyre, ndërsa për seancën e datës 12.03.2015, 13.05.2015, 21.09.2015, nuk ka pasur prova, si dhe për përpilimin e ankesës se datës 12.02.2016, kundër Aktgjykimit C.nr.2461/2009 shumen prej 614.00€, gjithsej shumen prej 4,664.40€.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 409.1 të LPK -

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të rregullt, për faktin se edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk është shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, megjithatë i njëjti aktgjykim është shoqëruar me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika i) në lidhje me nenin 182 par.1, e në lidhje me nenin 107 par.1, lidhur me nenin 110 par.1 dhe 111 par.1 të si dhe në lidhje me nenin 198 par.2 të LPK-së, dhe nga të cilat arsye edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë.

Nga ekzaminimi i shkresave të lëndës, konstatohet se gjykata e shkallës së parë, në procedurën e ri gjykimit, ka caktuar seancën përgatitore me datën 14.09.2023, dhe paditësve, u ka dërguar ftesën përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim njëherit edhe paditësi i pestë Z. M. nga fshati N./Komuna e ., dhe atë me datën 05.07.2023, nga ku konstatohet se ftesën në emër të Z. M. si palë ndërgjyqëse dhe i autorizuar edhe për paditësit tjerë, e ka pranuar Agron Lajçi(që

konstatohet se është miku i tij), dhe mbi bazën e kësaj, gjykata e shkallës së parë, pa u kujdesur se paditësit janë ftuar në mënyrë të rregullt sipas nenit 107 par.1, si dhe nenit 110 dhe 111 të LPK-së, në kundërshtim me këto dispozita ligjore ka nxjerr aktvendimin për tërheqje të padisë së paditësve kundër të paditurit mbi bazën e nenit 409 par.1 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës, mbi bazën e nenit 452 par.1 të LPK-së, dhe gjykata e shkallës së dytë, mbi bazën e vërtetimit të këtyre fakteve, vjen në përfundim se qëndrojnë të bazuara pretendimet ankimore të palës paditëse në ankesën e ushtruar së gjykata e shkallës së parë në kundërshtim me dispozitat e lartcekura pa u plotësuar kushtet ligjore ka nxjerr aktvendimin për tërheqje të padisë së paditësve, ngase në rastin konkret gjykata nuk ka vërtetuar faktin se pranuesi i dërgesës Agron Lajçi që evidentohet si mik i paditësit Z. M., a ka qenë i autorizuar për pranimin e ftesave për paditësit, a janë në raporte familjare pranuesi i ftesës dhe paditësi Z.M., dhe gjithashtu, nuk është konstatuar se pranuesi i ftesës Agron Lajçi, a është e moshës së mitur apo moshës madhore, ashtu që, duke iu referuar nenit 107 par.1 të LPK-së, ku përcaktohet se *“Kur palën e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor apo me prokurë, shkresa i dorëzohet përfaqësuesit ligjor, përkatësisht përfaqësuesit me prokurë”*, gjykata ka qenë e detyruar që ftesën për seancën e datës 14.09.2023, personalisht t’ia dorëzoj paditësit të pestë njëherit i autorizuar edhe për paditësit tjerë Z. M. nga fshati N./Komuna e P., dhe duke marrë për bazë faktin se përfaqësuesi i autorizuar njëkohësisht është edhe palë paditëse në këtë proces kontestimorë, atëherë, sipas nenit 110 par.1 të LPK-së, të njëjtit personalisht ishte dashtë ti dorëzohet ftesa për seancë përgatitore të datës 14.09.2023, ngase sipas nenit 110 par.1 të LPK-së, përcaktohet se *“ Padia, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këtillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i janë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar”*, ndërsa me nenin 111 par.1 parashihet se *“ Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtarit të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as këta nuk gjenden në banesë, shkresa do t’i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm.”*, dhe nisur nga këto dispozita ligjore, gjykata e shkallës së dytë, gjeti se paditësi Z. M. as si palë ndërgjyqëse sipas nenit 110 par.1 dhe 111 par.1 të LPK-së, por as si përfaqësues i palëve paditëse sipas nenit 107 par.1 të LPK-së, nuk është ftuar në mënyrë të rregullt prandaj, nxjerrja e aktvendimit të ankimuar për tu konsideruar e tërhequr padia e paditësve kundër të paditurit është bërë në kundërshtim me nenin 182 par.2, pika i), në lidhje me nenin 182 par.1, dhe nenin 107 par.1, si dhe nenin 110 par.1 e 111 par.1 të, po ashtu edhe në lidhje me nenin 198 par.2 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së parë duke mos dorëzuar me rregull ftesën i ka pamundësuar paditësve të jenë prezent në seancë përgatitore dhe të përfaqësojnë padinë dhe pretendimet e tyre në këtë çështje juridike, andaj, mbi bazën e këtyre arsyeve, aktvendimi i ankimuar është i pa qëndrueshëm dhe si tillë duhet të anulohet.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që fillimisht, konform nenit 107 par.1, 110 par.1 e në pamundësi të aplikimit të këtyre dy dispozitave ligjore mbi bazën e nenit 111 par.1 të LPK-së, paditësit Z. M. nga fshati N./Komuna e P., njëherit edhe si përfaqësues për paditësit

tjerë, t'ia dorëzoj ftesën për seancë gjyqësore personalisht, e në pamundësi të dorëzimit personal, ta zbatoj nenin 111 par.1 të LPK-së, dhe vetëm pas sigurimit të gjykatës se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore (mos ardhja e paditësve në seancë, mos arsyetimi i mos prezencës në seancë, mungesa e kërkesës së paditësve për shtyerje eventuale të seancës etj.), mund të nxjerr aktvendim për ta konsideruar padinë e paditësve të tërhequr, ashtu që, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të vazhdoj procedurën gjyqësore, të veproj sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit lidhur me çështjen meritorë, dhe pas ri administrimit të tërësishëm të provave dhe vërtetimit të plotë dhe drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr vendim të drejtë dhe në përputhje me ligjin në këtë çështje juridike.

Meqë, u anulua aktvendimi për çështjen kryesore, atëhere, konform nenit 465 par.3 të LPK-së, anulohet edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, varësisht nga suksesi i arritur i palëve në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, e në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika d) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 7542/23, dt:26.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka